UDHËZIM
Nr.10288, datë 24.11.2010

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.757, DATË 15.9.2010 "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE, PËR SHITJEN E SIPËRFAQES SË DOMOSDOSHME TË TRUALLIT, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SHOQËRITË TREGTARE, KU SHTETI ZOTËRON KUOTA APO AKSIONE"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të pikës 19 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.757, datë 15.9.2010 "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave, për shitjen e sipërfaqes së domosdoshme të truallit, për ushtrimin e veprimtarisë nga shoqëritë tregtare, ku shteti zotëron kuota apo aksione", Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Në zbatim të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.757, datë 15.9.2010, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës harton listën e shoqërive ku shteti zotëron kuota apo aksione, në të cilat trualli është dhënë në përdorim apo me qira, të cilat vazhdojnë aktivitetin e tyre dhe afati i tyre nuk ka përfunduar.

2. Me hartimin e kësaj liste Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nxjerr urdhrin përkatës për ngritjen e komisionit, rast pas rasti, për çdo shoqëri, për përcaktimin e sipërfaqes së domosdoshme që i nevojitet asaj për ushtrimin e veprimtarisë.

3. Në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi, përfaqësuesit e institucioneve përkatëse, të cilët janë anëtarë të komisionit, duhet të jenë persona që punojnë në drejtoritë që merren me menaxhimin e këtyre shoqërive dhe kryetar i komisioni për përcaktimin e sipërfaqes së domosdoshme që i nevojitet shoqërisë do të jetë përfaqësuesi i institucionit administrues.

4. Për përcaktimin e kësaj sipërfaqeje, komisioni do të bazohet në të gjithë dokumentacionin që disponon shoqëria që në momentin e krijimit, si dhe duke pasur parasysh aktivitetin që ushtron ajo.

5. Me miratimin e urdhrit, komisioni mblidhet dhe përcakton programin e punës lidhur me kryerjen e kësaj procedure brenda afateve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.757, datë 15.9.2010.

6. Ekspertët vlerësues të pasurisë së paluajtshme, anëtarë të komisionit, do të marrin një pagesë prej 300 000 lekësh, ndërsa anëtarët e tjerë të komisionit do të paguhen me 5000 lekë secili. Kjo pagesë do të kryhet nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.428, datë 9.6.2010.

7. Me kryerjen e procedurave të përcaktuara në pikat 4 deri 7 të vendimit, komisioni harton raportin përkatës, i cili duhet të jetë i firmosur nga të gjithë anëtarët dhe ia dërgon atë për miratim Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, së bashku me të gjithë dokumentacionin përkatës. Për çdo vendim të kundërt, ato duhet të jenë bashkëlidhur këtij raporti.

8. Me marrjen e këtij dokumentacioni, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës bën shqyrtimin e tij dhe nëse e gjen atë të rregullt, e miraton. Nëse nuk e gjen të rregullt, ia kthen atë komisionit. Kthimi i dokumentacionit do të bëhet me firmë të titullarit të Ministrisë. Komisioni duhet të bëjë rregullimet përkatëse brenda një afati 30-ditor (tridhjetë) nga marrja e tij.

9. Me miratimin e këtij dokumentacioni, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës i bën me dije shoqërisë kryerjen e procedurave për shitjen e truallit të domosdoshëm që i nevojitet asaj për ushtrimin e veprimtarisë së tij.

10. Me kryerjen e këtyre procedurave Ministra e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të gjithë dokumentacionin ia dërgon Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave.

11. Me marrjen e dokumentacionit përkatës, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave kryen verifikimin e tij dhe nëse e gjen në rregull kryen procedurat e përcaktuara në pikat 9 deri 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.757, datë 15.9.2010.

12. Në zbatim të pikës 15 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.757, datë 15.9.2010, në rastet e shitjes së truallit shoqërisë, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, duhet të derdhë, në favor të pronarit të truallit, vlerën e truallit përkatës për kompensim financiar.

Njoftimit me shkrim duhet t'i bashkëlidhet dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për ish-pronarin;
- Kontrata e shitjes së truallit;
- Autorizimi për kalim pronësie;
- Mandatpagesat që lidhen me pagesat e truallit.

Ish-pronari i truallit që do të përfitojë kompensim financiar duhet të paraqesë në Ministrinë e Financave (sektori i financës dhe buxhetit) dokumentacionin ligjor si më poshtë:

- Kërkesën me shkrim për kompensim financiar për truallin ish-pronë e tij;
- Dokument identifikimi (letërnjoftim, pasaportë apo certifikatë me fotografi);
- Dëshmi trashëgimie;
- Prokurë të posaçme përfaqësimi.
- Numrin e llogarisë personale të hapur pranë një banke të nivelit të dytë.

Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, pas njoftimit të marrë nga sektori i financës dhe buxhetit në Ministrinë e Financave, njofton me shkrim zyrën rajonale të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe AKKP-në për kompensimin financiar të kryer në favor të subjekteve të shpronësuara jo më vonë se 5 ditë nga data e realizimit të kompensimit financiar.

13. Në zbatim të pikës 18 të vendimit në rastet kur shoqëria nuk pranon të blejë truallin, marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë dhe pronarëve të truallit të njohur me vendim të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave rregullohen me anë të një kontrate konform dispozitave të Kodit Civil. Në këtë rast shoqëria duhet të marrë një vendim të asamblesë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Ilir Meta

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode